

VENDIM
Nr. 72, datë 8.4.2025

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “5GX ENERGY” SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET VENDOSJES SË BARRËS SIGURUESE) TË ASETVE FIKSE TË SAJ

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 35/13 prot., datë 1.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “5GX Energy” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të saj”,

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e kërkesës për licencim

- Shoqëria “5GX Energy” sh.a., më datë 8.1.2025 dorëzoi kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) e aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Tirana Bank” sh.a.

2. Fillimi i procedurës për transferimin e aseteve

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 26, datë 27.1.2025, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë.

- ERE ka njoftuar shoqërinë dhe MIE-n, në lidhje me këtë vendim nëpërmjet shkresës nr. 35/5 prot., datë 6.2.2025.

3. Vlerësimi i dokumentacionit dhe kërkesa për seancë dëgjimore

- Me shkresat nr. 35/3 prot., dhe nr. 35/4 prot., datë 3.2.2025, ERE njoftoi shoqërinë dhe Tirana Bank sh.a. për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 13.2.2025, duke i kërkuar shoqërisë plotësimin e dokumentacionit të munguar, përfshirë: gjendjen financiare në momentin e paraqitjes së kërkesës, marrëveshjen paraprake me listën e aseteve, çdo transferim të mëparshëm, si dhe qëndrimin lidhur me faktin që marrëveshja është nënshkruar pa marrë më parë autorizimin e ERE-s.

- Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 35/6 prot., datë 18.2.2025, ERE kërkoi depozitimin e angazhimeve të deklaruara gjatë saj. Gjatë seancës, përfaqësuesit e bankës dhe të shoqërisë deklaruan se do të anulonin marrëveshjen ekzistuese të barrës siguruese mbi asetet e shoqërisë, do të kryenin fshirjen e saj nga Regjistri i Barrës Siguruese dhe do të paraqisnin pranë ERE-s një marrëveshje të re, e cila do t'i nënshtrohej më parë miratimit të institucionit.

4. Dorëzimi dhe vlerësimi i dokumentacionit plotësues

- Pas seancës dëgjimore të datës 13.2.2025, në mungesë të dokumentacionit përkatës, ERE, me shkresën nr. 35/6 prot., datë 18.2.2025, u kërkoi shoqërisë dhe bankës depozitimin e angazhimeve të deklaruara. Më pas, me shkresën nr. 35/7 prot., datë 19.2.2025, shoqëria kërkoi pezullimin e shqyrtimit deri në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

- Me *e-mail*-in e datës 24.2.2025, ERE kërkoi dorëzimin e dokumentacionit të munguar që varej vetëm nga shoqëria, si dhe një afat të arsyeshëm për përmbushjen e tij. Si përgjigje, me shkresën nr.

35/8 prot., datë 27.2.2025, shoqëria plotësoi pjesërisht dokumentacionin dhe kërkoi pezullimin e procedurës deri më 17.3.2025.

- Në datën 17.3.2025, Tërana Bank sh.a., me shkresën nr. 35/9 prot., shoqëria dorëzoi marrëveshjen e re siguruese nr. 534 rep., nr. 384 kol., datë 12.3.2025 dhe vërtetimin e fshirjes nga RBS të marrëveshjes së mëparshme nr. 2691 rep., nr. 1731 kol., datë 10.12.2024. Në të njëjtën datë, edhe shoqëria, me shkresën nr. 35/10 prot., përcolli të njëjtin dokumentacion.

- Me shkresën nr. 35/11 prot., datë 18.3.2025, ERE kërkoi sqarim nëse data 17.3.2025 përfaqëson dorëzimin final të dokumentacionit apo datën e pritshme të formalizimit. Në vijim, me shkresën nr. 35/12 prot., datë 20.3.2025, shoqëria depozitoi marrëveshjen e re siguruese nr. 533 rep., nr. 383 kol., datë 12.3.2025, për vendosjen e barrës së radhës së parë në favor të Tërana Bank sh.a., e bashkëlidhur këtij relacioni.

5. Shtyrja e afatit të vendimmarrjes

- Referuar nenit 67 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i ERE-s vlerëson zgjatjen me 30 ditë të vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “5GX Energy” sh.a. për transferimin e aseteve fikse të saj nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE mbi kërkesën e shoqërisë “5GX Energy” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Tërana Bank” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “5GX Energy” sh.p.k. vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti